

HYRJE

Sot ne daten 01.10.2020 , ne mbeshtetje te ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit" qe rregullojne marredheniet tregtare dhe funksionimin e shoqerive tregtare:

- **SOKOL AGALLIU** i biri i Maneshit dhe i Sulltanes , shtetas Shqiptar, i datelindjes 08.08.1958, banues ne **VLORE** , Lagjja "Hajro Cakerri", Rruga Kuzumbaba, nr.10 , madhor me zotesi te plote per te vepruar , vendosa te miratoj statusin e shoqerise anonime **"VELLEZERIT AGALLIU 20" SHA** si vijon:

STATUTI

I SHOQERISE ANONIME

"VELLEZERIT AGALLIU 20" SHA

KAPITULLI I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

KREU I

OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK, AFATET

Shoqeria “ **VELLEZERIT AGALLIU 20** ” SH A nepermjet ketij Statuti, ne perputhje me Aktin e Themelimit per krijimin e saj, bazuar ne legjislacionin shqiptar ne fuqi, rregullon gjendjen juridike te shoqerise, marredheniet e saj me te tretet, te dhenat me rendesi per poziten juridike te ortakeve ne raport me shoqerine dhe te tretet, organet drejtuese dhe kompetencat e tyre, organizimin dhe objektin e veprimtarise se shoqerise, si dhe ceshtje te tjera me rendesi per mbarevajtjen e Shoqerise . Cdo ceshtje qe nuk eshte shprehimisht e trajtuar ne kete Statut, do te interpretohet ne perputhje me frymen e tij, nisur nga parimet e mirebesimit, bashkepunimit dhe interesit reciprok te ortakeve te shoqerise.

NENI 1

OBJEKTI I SHOQERISE

1.1. Objekti i veprimtarise se shoqerise ne perputhje me legjislacionin shqiptar do te jete:

“ Tregtim me shumice i makinerive e veglave te punes. Tregti me shumice i vajrave lubrifikante, naftes import eksport i tyre, Tregti me shumice e pakice te artikujve te ndryshem industriale dhe ushqimore, materialeve te ndertimit, hidrosanitare, elektrike, elektroshtepiake , pajisjeve te kembimit te automjeteve, pajisjeve te zyrave , import - eksporti i tyre . Aktivitet ne fushen e transportit per vete dhe per te trete . Transport nacional dhe internacional. Transport mallrash dhe pasagjeresh . Hapje bar-resorantesh . Vepritari ne fushen e piceri , aktivitet ne fushen e hotelerise . (Vepritari sipas Aktit te Themelimit te “**VELLEZERIT AGALLIU 20**” SHA). Import bojrash industriale per lyerje konstruksionesh, anijesh, tuboshceliku etj .”

NENI 2

EMERTIMI DHE SELIA JURIDIKE E SHOQERISE

- 2.1. Emertimi i Shoqerise eshte a **"VELLEZERIT AGALLIU 20" SH.A.**
- 2.2. Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen: **Godina e Vellezerve Agalliu, Rruga Nationale Vlore-Fier, Skrofotine, Godina Nr 1, Vlore.**
- 2.3. Shoqeria mund te krijojte filiale, zyra perfaqesimi e agjensi ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.
- 2.4. Adresa e aksionereve ne marredheniet me Shoqerine do te jete ajo qe rezulton e shenuar ne librin e Shoqerise.

NENI 3

REGJIMI JURIDIK

- 3.1. Forma juridike e shoqerise eshte **shoqeri aksionere**. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit, si dhe legjislacionit ne fuqi. Ligji i aplikueshem per zgjidhjen e cdo mosmarrveshje eventuale qe lind gjate aktivitetit te shoqerise eshte ligji shqiptar.
- 3.2. Kompetente per zgjidhjen e mosmarreveshjeve te parashikuara ne paragrafin e mesiperm eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Vlore
- 3.3. Me vendim unanim, aksioneri mund te ndryshojne regjimin juridik te Shoqerise, ne qofte se ne te ardhmen krijohen premisa me te favorshme per funksionimin e saj.

3.4. Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit.

NENI 4

KOHEZGJATJA

4.1. Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise **"VELLEZERIT AGALLIU 20"** SH A eshte deri ne 31 Dhjetor 2030.

KREU II

ORGANET DREJTUESE, MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I SHOQERISE, EKSPERTET

NENI 5

ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese te Shoqerise aksionere **" VELLEZERIT AGALLIU 20 "** SH A jane:

1) Keshilli i Administrimit i cili emerohet prej asamblese se aksionereve per nje periudhe 3 (tre) vjecare. Asambleja ka te drejte ne cdo kohe te ndryshoje anetaret e keshillit te administrimit dhe menyren e administrimit i cili perbehet nga

Anëtarët e Këshillit të Administrimit

Kryetari

1-1 Jonian Omeri, me karte identiteti I70722110V per nje periudhe 3 vjecare , nga 02/10/2020 deri ne 01/10/2023.

Antare

1-2 Valentina Agalliu, me karte identiteti G36231076D per nje periudhe 3 vjecare , nga 02/10/2020 deri ne 01/10/2023.

1-3 Albion Asllanaj me karte identiteti J012180570 per nje periudhe 3 vjecare , nga 02/10/2020 deri ne 01/10/2023.

- 2) **Administratori i Shoqerise**, (sistemi me nje nivel sipas nenit 154 te ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregtare").

NENI 6

E DREJTA E VOTES

- 6.1.** Kane te drejten e votes aksioneret e shkruar ne librin e aksioneve.
- 6.2.** Ne cdo rast vota i takon cdo aksioneri ne mase perpjestimore me pjesemarrjen e tij ne kapitalin e shoqerise.
- 6.3.** Aksioneri subjekt i detyrimit qe do te merret me shqyrtim, nuk mund te marre pjese ne votim.

NENI 7

KOMPETENCAT E ASAMBLESE SE AKSIONEREVE

- 7.1** Asambleja e aksionereve vendos per ceshtje qe ligji dhe ky statut i le eksluzive ne kompetence te asamblese se aksionereve si dhe per ceshtje qe nje apo me shume administratre ose disa aksionere qe perfaqesojne 10% (dhjete per qind) te kapitalit te shoqerise ua parashtrrojne per shqyrtim.
- 7.2** Sidoqofte, pervec sa parashikohet ne nenet e ketij statuti, i

rezervohen kompetences se asamblese se aksionereve ceshtjet e meposhtme per:

- Miratimin e bilancit
- Emertimi dhe shkarkimi i keshillit te administrimit
- Ndryshimin e statutit
- Zmadhimin apo zvogelimin e kapitalit themeltar;
- Pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- Perfaqesimin e shoqerise ne Gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- Transferimin e pjeseve te kapitalit themeltar tek te tretet;
- Zgjatjen e kohes se veprimtarise se shoqerise apo prishjen e saj dhe kalimin ne proces likuidimi;
- Shnderrimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ne forma te tjera;
- Dhenia e garancive me vlere me te madhe se Euro 100.000 (njqindemije)
- Marrja e obligacioneve ne emer te shoqerise me vlere me te larte se Euro 100.000 (njqindmije)

ADMINISTRATORI

8.1. Administrator i shoqerise "VELLEZERIT AGALLIU 20" SH A te jete Z.SOKOL AGALLIU deri me 01.10.2023.

NENI 9

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT/VE

9.1. Administratori drejton gjithë veprimtarine e Shoqerise ne pikpamjen tekniko-organizative, ka te gjitha kompetencat per te vendosur ne lidhje me aktivitetin e zakonshem dhe te perditshem te shoqerise. Administratori gezon te drejta te plota ne vendim-marrje dhe gezon kompetenca te plota, pervec atyre qe ky statut apo ligji ia njohin Asamblese se Pergjithshem.

9.2. Te Drejta dhe Detyrimet e Administratorit te shoqerise:

- Ne rastin e administrimit me nje administrator , ai do kete te drejten te kryeje veprimet e parashikuara ne piken e mesiperme per veprime shitblerje pasurise te plujtshme dhe paluajtshme, operacione bankare (pagesa e terheqje), marrje kredie e venie garancish me pasurie te luajtshme e te paluajtshme me vlere deri ne Euro 250.000 (Dyqind e pesedhete mije Euro)
- Ne rast se administratori u eshte besuar vec e vec disa administratoreve, ne rast kundershimi te nje administratori kundrejt veprimit qe administratori tjetër synon te kryeje ,

kompetete për të vendosur mbi kundërshtite është keshilli i administrimit.

- Administratores mund të emëtojnë drejtore , përgjegjës të shërbimeve të veçanta, përfaqësues për akte të vetme apo për kategori aktesh
- Administratores kanë të drejtën të shpërblehen për shpenzimet e kryera në funksion të punës për shoqërinë, si dhe për punën e kryer në favor të shoqërisë, aksioneret mund t'i caktojnë një shpërblim apo kompesim. Në rast se asgjë nuk është vendosur në lidhje me shpërblimin e administatoreve, detyra duhet kuptuar si e kryer falas. Në rastin caktimi të një apo disa keshilltareve, shpërblimi i tyre do caktohet nga asambleja e aksionereve , në momentin e emërimit të tyre apo edhe më pas.
- të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga keshilli i administrimit ;
- përfaqëson shoqërinë aksionere; kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për

miratim;

- krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblenë e përgjithshme për sa parashikon ky statut ose ligji.

NENI 10

AUDITI LIGJOR (EKSPERTET KONTABEL TE AUTORIZUAR)

Kontrolli financiar ushtrohet nga dy ose me shume AUDITUESA LIGJORE (eksperte kontabel te autorizuar) te cilet emerohen nga Asambleja e Zakonshme dhe kryejne funksionin ne pajtim me ligjin.

Auditues Ligjor (Eksperti kontabel) emerohet Studioja Audituese "A & E AUDITING "shpk me me numer lishence 139 date 28.01.2005.

Ne cdo kohe te vitit ekspertet kontabel te autorizuar se bashku ose vec e vec bejne te gjitha verifikimet e kontrollet qe i gjykojne te domosdoshme dhe mund te shfrytezojne ne vend te gjithe dokumentacionin e vleresuar si te dobishem ne ushrimin e funksionit te tyre dhe ne vecanti kontratat, librat e llogarise, dokumentat kontabel dhe regjistrat e procesverbalet. Ekspertet kontabel informojne Keshillin e administrimit dhe administratoret per :

-kontrollet,verifikimet dhe sondazhet e kryera

-verejtjet lidhur me bilancin dhe pasqyrat financiare e dokumentet e tjere kontabel

-parregullsitet dhe pasaktesitet qe kane konstatuar

Ekspertet kontabel te autorizuar thirren ne mbledhjen e Keshillit te Administrimit kur mbyllen llogarit e vitit financiar si dhe mbledhjes se asamblese. Ata jane pergjegjes si ndaj shoqerise ashtu edhe ndaj te treteve per pasojat qe rrjedhin per faj dhe nenvleftesimin e tyre gjate ushtrimit te funksioneve qe kane. Honoraret e eksperteve kontabel te autorizuar i ngarkohen shoqerise. Keshilli i administrimit me rastin e miratimit te eksperteve miraton edhe masen e shperblimit te tyre.

KREU III

MJETET E SHOQERISE, KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT

NENI 11

KAPITALI THEMELTAR

11.1. Kapitali i regjistruar i Shoqerise “ **VELLEZERIT AGALLIU 20** ” **SH A** eshte 105.646.782 leke, dhe eshte i ndare ne 1 (nje) aksione me vlere nominale 105.646.782 leke cdo aksion. Kapitali i shoqerise eshte nenshkruar dhe eshte derdhur teresisht nga aksioneret perkateshisht :

- SOKOL AGALLIU ka shlyer 100 % te kapitalit te shoqerise.

11.2. Kapitali fillestar mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimit te ortakut te vetem themelues te shoqerise .

NENI 12

KUOTAT E KAPITALIT

12.1. Rritja e kapitalit te shoqerise u perkasin me prioritet aksionereve ne raport me pjesemarrjen ne zotesim te tyre. Ne rastin kur nje apo me shume aksionere nuk do te nenshkruajne plotesisht rritjen, pjesemarrja e mbetur pa nenshkruar do tu ofrohet ne parablerje aksionereve te tjere qe kane ushtruar tagren, ne raport me pjesemarrjen ne zoterim te tyre. Sidoqofte kjo e drejte do te duhet te ushtrohet brenda 15 diteve. Vetem nese rritja e kapitalit nuk nenshkruhet prej aksionereve te shoqerise, pjesa qe mbetet e panenshkruar ajo mund tu ofrohet per blerje te treteve.

12.2. Shoqeria do te mund te marre prej aksionereve derdhje dhe financime, me forme detyrimi apo gratis, me apo pa detyrimin e shlyerjes, duke zbatuar aktet ligjore ne fuqi. Pervec nese eshte rene dakort ne tjetere menyre me forme te shkruar, derdhjet e bera nga aksioneret ne favor te

shoqerise nuk do te jene ne asnje rast me interesa.

12.3. Krediti i aksionereve per financimin e shoqerise nuk mund te transferohet vecmas kuotes se pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerise. Transferimi i aksioneve te shoqerise perfshine edhe kalimin ne rruge trashegimie, si persa i perket derdhjes ne kapitalin fillestar edhe lidhur me rritjen e kapitalit, keshtu qe transferimi do sjelle ne menyre automatike zevendesimin e pales dhenese te te drejtes, si subjekt kreditor pro kuotes, te vleres se derdhur me kete titull, si dhe miratimin e vete shoqerise per te kryer ndryshimin perkates ne librat e shoqerise.

NENI 13

AKSIONET E SHOQERISE

13.1. Aksionet jane te pandashme, nominale dhe te transferueshme edhe me ane akti mes te gjalleve sipas normave te ketij statuti dhe ligjit Nr 9901 date 14.04.2008.

13.2. Ky nen synon te mbroje interesat e shoqerise lidhur sidomos me homogjenitetin e perberjes se shoqerise, me kohezionin mes aksionereve dhe ekuilibrin e raporteve mes tyre. Per kete arsye vendosen kufizimet e meposhtme per rastin e transferimit te aksioneve.

1. Me pjesemarrje

2. Me transferim

3. Me transferim me akt mes te gjalleve

NENI 14

KUFIZIME NE TRANSFERIMIN E AKSIONEVE

- 14.1.** Me "pjesemarrje" (ose me "pjesemarrjet") nenkuptohet pjesa e kapitalit te secilit aksioner apo pjese te saj (aksionet ne rast transferimi te pjesshem dhe/ose edhe te drejtat e nenshkrimit qe i perkasin asaj.
- 14.2.** Me "Transferim" nenkuptohet transferimi me akt mes te gjalleve
- 14.3.** Me shprehjen "transferim me akt mes te gjalleve" nenkuptohen te gjitha institutet e transferimit ne kuptimin me te gjere te termit, pra shitja ,shkembimi, cedimi , cedimi me pagese, transferimi i mandatit fiduciar dhe dhurim.

KREU IV

VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, NDARJA E FITIMEVE, DIVIDENTET

NENI 16

VITI FINANCIAR

- 16.1.** Cdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.
- 16.2.** Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratoret dhe eventualisht, nga eksperti kontabel i autorizuar, miratohen nga

asambleja me shumicen e ortakeve qe zoterojne mbi 1/2 e kapitalit themeltar.

16.3. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati te caktuar prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

NENI 17

LLOGARITE FINANCIARE

17.1. Ne fund te cdo viti kalendarik duhet te hartohet nje bilanc si dhe nje llogaritje te fitimeve dhe humbjeve. Me kete duhet te ngarkohen eksperte (keshilltare taksash revizore etj). Fitimi i shoqerise ndahet si me poshte:

17.2. 5 % merren si rezerve ligjore ne rezerva derisa jane arritur 10 % te kapitalit themeltar,

17.3. Shuma e mbetur ndahet midis ortakeve sipas pjeseve te tyre ne shoqeri.

17.4. Forma e bilanceve dhe librave te llogarise qe do te mbaje shoqeria, percaktohen nga Asambleja e Pergjithshme.

NENI 18

DIVIDENTET

18.1. Pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidentimit te ekzistences se fitimeve, Asambleja e Pergjithshme percakton pjesen qe u takon ortakeve ne formen e dividendeve. Fitimi, qe do te ndahet midis

ortakeve, ne proporcion me pjeset e kapitalit themeltar, perbehet nga fitimi i vitit financiar, te cilit i jane zbritur shumat e lena menjane per fondin rezerve te domosdoshem (5% e fitimit te cdo viti deri sa ky fond te arrije vieren e 1/10 e kapitalit themeltar) dhe nga ana tjeter i jane zbritur ose shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e meparshme.

KREU V

KUFIZIMI I AFATIT, PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

NENI 19

NDRYSHIMET E AFATIT

19.1. Kufizimi apo zgjatja e afatit te aktivitetit te shoqerise mund te vendoset me shumicen e aksionereve.

NENI 20

PRISHJA E SHOQERISE

20.1. Ne cdo moment dhe per cfaredo shkak shqeria mund te shperndahet me vendim unanim te asamblese se aksionereve, normat per likujdimin dhe per emertimin e likuidatorit apo likuidatoreve do te vendosen prej Asamblese se Aksionereve sipas dispozitave te legjislacionit shiptar ne fuqi.

20.2. Shkaqet e prishjes se Shoqerise;

- a. kur mbaron kohezgjatje e parashikuar ne themelimin e saj
- b. me vendim te Asamblese se Pergjithshme
- c. me hapjen e procedurave te falimentimit.
- d. nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne Q.K.R
- e. me Vendim Gjykate

NENI 21

LIKUIDIMI I SHOQERISE

- 21.1.** Shoqeria hyn ne procesin e likuidimit qe ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi Asambleja emeron nje ose disa likuidues te cilet i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe te pasivitetit te shoqerise, mbi ndjekjen e operacioneve te likuidimit dhe mbi afatin e domosdoshem te perfundimit te tyre.
- 21.2.** Ne fund te procesit te likuidimit Asambleja vendos, me shumicen e ortakeve qe zoterojne mbi 3/4 e kapitalit themeltar, mbi bilancin perfundimtar financiar, mbi aktin e rregullshmerise te punes se likuiduesit dhe mbylljen e procesit te likuidimit.
- 21.3.** Pas pagimit te kreditoreve dhe shlyerjes se pjeseve te kapitalit themeltar tek kontribuesit perkates, likuiduesi ndan kapitalet e mbetura ndermjet ortakeve proporcionalisht me pjeset qe ata

zoterojne ne kapitalin themeltar dhe njofton Q.K.R per perfundimin e likujdimit dhe kerkon c'rregjistrimin e Shoqerise.

KREU VI

DISPOZITA TE FUNDIT

NENI 22

INTERPRETIMET STATUTORE

- 22.1.** Pavlefshmeria e dispozitave te vecanta te kesaj marreveshje nuk e prek teresine e saj vepruese. Ne vend te dispozitave te pavlefshme ose per mbushjen e hapsirave statutore, ortaket bien dakord per nje rregullim te pershtatshem, ne perputhje me qellimin e hartimit te ketij statuti, duke ruajtur interesat e perbashketa.
- 22.2.** Per gjithshka jo te parashikuar ne kete statut do te respektohen normat ligjore te legjislacionit shqiptar ne fuqi.
- 22.3.** Gjykate kompetente per zgjidhjen e te gjitha mosmarreveshjeve qe mund te lindin gjate ekzistences se shoqerise, ose gjate periudhes se likujdimit ndermjet ortakeve, ndermjet shoqerise dhe ortakeve, apo ndermjet shoqerise dhe te treteve, do te *jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Vlore*
- 22.4** Ky Statut hartohet ne 4 ekzemplare origjinale, hyn ne fuqi ditën e nenshkrimit nga Ortaket e Shoqerise “ **VELLEZERIT AGALLIU 20** ” SH A.

NENI 23

DISPOZITA TE FUNDIT

- 23.1** Per te gjitha çeshtjet qe nuk gjejne rregullim ne kete Statut, aplikohen dispozitat e ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Per tregetaret dhe shoqerite tregtare".
- 23.2** Per efekt te interpretimit te ketij Statuti me ligj tregtar nenkuptohet ligji nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Per tregetaret dhe shoqerite tregtare"
- 23.3** Pavlefshmerite eventuale te dispozitave te veçanta te Statutit nuk mund te cenojne vlefshmerine ne teresi te tij.

Date 01.10.2020

" VELLEZERIT AGALLIU 20 " SH A

AKSIONERI

SOKOL AGALLIU

